

V E N D I M
Nr.8, datë 7.1.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.393, DATË
3.9.1992 “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 bëhet ky ndryshim:
“Kryeministri dhe Zëvendëskryeministri mund të caktojnë këshilltarë të jashtëm, specialistë të shquar të fushave të ndryshme, që kanë përvojë pune, vendas ose të huaj.
Ministrat caktojnë deri në 3 këshilltarë të jashtëm, të cilët mund të zgjidhen prej specialistëve të shquar të fushave të ndryshme, që kanë përvojë pune.
Këshilltari i jashtëm, i cili nuk ka shtetësinë shqiptare, caktohet nga ministri me miratim të Kryeministrit.
Këshilltari i jashtëm mund të jetë honorifik ose mund t’i jepet për punën e kryer, një shpërblim mujor deri në 40 për qind të pagës bazë mujore të këshilltarit të brendshëm të institucionit. Masa e shpërblimit caktohet nga titullari i institucionit.”
2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.439, datë 3.9.1993 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore””, pika 2 shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I
Pandeli Majko